



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 15  
Prishtinë, më 06 korrik 2011, në orën 10:30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

**Të ftuar:** Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Fahri Breznica –zyra e presidentit, Sami Kurteshi –institucioni i Avokatit të Popullit.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Fatime Qorri – koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 29.06.2011,
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare për Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
5. Të ndryshme.

*Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 29.06.2011

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29.06.2011.*

## 3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare për Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

**Kryetari** – Opinioni i ZAP-it për pasqyrat financiare të Zyrës së Presidentit është i pakualifikuar. Vitin e kaluar janë dhënë 8 rekomandime, dy prej tyre janë zbatuar, katër janë në proces të zbatimit dhe dy nuk janë zbatuar fare. Kërkoj koment lidhur me këtë. Ka pasur shkurtim buxhetor. Pse ka ndodh kjo?

**Fahri Breznica** – Zyra e Presidentit ka marrë seriozisht rekomandimet e ZAP-it. Zyra e Presidentit ballafaqohet me probleme të mëdha si: planifikimi më i mirë i buxhetit për kategorinë paga dhe mëditje. Ish-presidenti Sejdiu ka marrë vendim për pagat e këshilltarëve politik dhe që ka qenë analog me pagat e këshilltarëve në Kuvend. Mirëpo Ministria e Financave nuk ka aprovuar këtë buxhet për këta këshilltar- nga kjo pastaj del konkluzioni i auditorit se pagat e këshilltarëve politik janë paguar nga kategoria mallra dhe shërbime. Nga tetori i vitit 2010 pas rishikimit buxhetor Ministria e Financave ka rritur kategorinë paga dhe mëditje dhe pagesa e këshilltarëve nga kjo kohë është bërë nga kjo kategori. Lidhur me realizimin e buxhetit për investime kapitale njoftoi komisionin për projektin e paraqitur në Ministrinë e Financave para 6 viteve për ndërtimin e “Shtëpisë së Bardhë”. Ky projekt nuk ka filluar asnjëherë. Projekti kushton 74 milion dhe janë ndarë 1.100.000 euro. Tani janë duke u bërë përpjekje që ky projekt të modifikohet dhe t'i përshtatet mundësive buxhetore. Zyra e Presidentit është duke bërë përpjekje që të forcoj sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në këtë drejtim ka përmirësime. Ka 39 të punësuar civil dhe buxheti në nuk është rrit pothuajse asnjëherë. Zyra ka kërkuar vazhdimisht që stafi civil të trajtohet ngjashëm si stafi civil në Kuvend. Kuvendi ka vendosur për shkurtim buxhetor prej 1 milion e 75 mijë euro.

**Ramiz Lladrovci** – Përkundër opinionit pozitiv të ZAP-it të gjeturat janë shqetësuese. Pyeti; a ka qenë i njëjti sekretar edhe në vitin 2009? Pavarësisht vendimit të presidentit ligji duhet zbatuar. Gabimi është bërë kur pagesa e këshilltarëve politik është bërë nga kategoria mallra dhe shërbime. Lidhur me mjetet që janë tërhequr nga Qeveria, pyeti: a janë ndarë ato mjete për fillimin e punimeve të presidencës apo janë ndarë për shërbime të tjera? Ato mjete është dashur të shpenzohen, sepse në të kundërtën mjetet tërhiqen kjo është e parashikuar me ligj.

**Valbona Dibra**- Përgëzoi për opinionin pozitiv, mirëpo është shqetësuese planifikimi i buxhetit, konkretisht në investimet kapitale. A janë 1 milion e 435 mijë e 70 euro për projektin “Shtëpia e Bardhë”, apo ka pasur të planifikuar diçka tjetër. Është absurde të projektosh një milion e gjysmë dhe të mos realizosh asnjë cent. Çështja e shërbimeve komunale është shqetësuese, sepse janë fikse dhe si ka mundur të ndodh që të ndahen 52 mijë euro dhe të shfrytëzohen vetëm 15 mijë euro? Pse nuk është bërë një planifikim më i mirë i buxhetit lidhur me këtë? Pagesa e këshilltarëve politik – paga nuk ka qenë korrespondente me këshilltarët e tjerë politikë. A ka qenë vendim i presidentit apo i stafit? Si janë bërë këto pagesa në thesar nga kategoria mallra dhe shërbime?

Blerjet përmes prokurimit – shtypja e 6000 ekzemplarëve. Është zgjedhur ofertuesi më i lirë me çmimin 5950 euro dhe kontrata është nënshkruar me një vlerë më të lartë prej 9550 euro. Zyra ka pranuar 10 mijë ekzemplarë sasi kjo që nuk është kërkuar, nuk është ofertuar. Kërkoj sqarim lidhur me këtë.

**Fahri Breznica** – Presidenti ka të drejtë të emëroj këshilltarët e tij politik. Ekziston vendimi me ish-ministrin e financave lidhur me shumat e këtyre pagave. Investimet kapitale kanë qenë në dy kategori: shtëpia e bardhe dhe një autoveturë të blinduar. Sipas sugjerimeve të Policisë së

Kosovës eskorta e presidentit duhet të ketë më shumë se dy vetura të blinduara. Në atë kohë presidenti ka dhënë dorëheqje, ka marrë detyrën ushtruesi i detyrës dhe asnjëri nuk ka qenë në gjendje pa presidentit të marrë përgjegjësi dhe si rezultat i kësaj mjetet janë kthyer. Ministria e Financave vendos kufijtë buxhetor. Shtypja e ekzemplarëve - tirazhi i dy gazetave ditore që kemi kontaktuar ka qenë afër 10 mijë copë.

**Fehmi Selimi** – Në kategorinë paga dhe mëditje nuk ka pasur mjete, se pasojë e kësaj janë kryer pagesat për paga nga kategoria mallra dhe shërbime. Me rishikim të buxhetit të vitit 2010 janë ndarë 68 mijë euro. Mbi këtë bazë këshilltarët politik janë përfshirë në listë të pagave mirëpo, problemi prapë do të përsëritet, sepse me rishikim të vitit 2010 nuk është paraparë ajo rritje e buxhetit për vitin 2011, por buxheti i pagave është kthyer në atë shumë që ka qenë në vitin 2009. Tani problem do të jetë edhe paga e ish-presidentit të ndjerë. Nga subvencionet është paguar kjo pagë, por tani kjo është hekur.

**Muhamet Mustafa** – Tha se problemet që ka Zyra e Presidentit duhet t'i diskutoi me Komisionin për Buxhet dhe Financa. Këto duhet rregulluar në buxhet sepse nëse Zyra e Presidentit nuk ka nevojë për atë shumë të mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime dhe në të njëjtën kohë kanë mungesë të mjeteve në kategorinë paga dhe mëditje, atëherë pse mos t'ju lejohet korrigjimi i buxhetit. Mirëpo, kjo duhet të bëhet në mënyrë transparente.

**Lars Lage OLOFSSON** – Sqaroi se në raport nuk thuhet asgjë rreth nivelit të pagave. Niveli i këtyre pagave vendoset në Ministrinë e Financave. Të gjeturat e ZAP-it mbeten, por çështja e fletushkave – nuk është një punë e kryer mirë me paratë e taksapaguesve, sepse sa më shumë printime të këtyre fletushkave - çmimi për njësi bie e jo te ngritët.

**Albert Kinolli** – Realizimi i buxhetit është i vogël vetëm prej 45% dhe duke pasur parasysh faktin se ka mospërputhje në realizimin e buxhetit të gjeturat janë shqetësuese. Kërkoj sqarim sa i përket tenderit dhe sasisë së ekzemplarëve. Tenderin e ka fituar fituesi më i lirë, ndërsa kontrata është nënshkruar prej 9550euro, kërkoj sqarim lidhur me këtë. Pyeti: sa është paga e një këshilltari politik?

**Fehmi Selimi** - Shpallja është bërë për 6mijë, mirëpo është paraqitë nevoja për një numër më të madh dhe meqenëse çmimi ka qenë më i ulët është rritur numri. Çmimi ka qenë për copë dhe është rritur numri i ekzemplarëve.

**Mursel Haljilji** – Te çështja e ekzemplarëve - nuk bëhet fjalë për rritjen e numrit të ekzemplarëve, por bëhet fjalë për rritjen e çmimit për ekzemplarë. Kjo nuk është dashur të ndodhë.

**Ramiz Lladrovci** –Ligji ka përcaktuar pagat dhe kjo e gjetur nuk guxon të përsëritet. Ka shkelje në prokurim, ka shkelje te sigurimi i tenderit ku kërkohet me 10% Zyra e Presidentit ka lejuar me 2%, kjo nuk guxon të ndodhë.

**Afrim Hoti** – Pyeti: kush e përcakton rritjen e pagave të këshilltarëve?

**Kryetari** - Pagat përcaktohen në nivel të Qeverisë, për të gjitha kategoritë, një vendim që figuron në Ligjin e buxhetit në bazë të shumës së përgjithshme, pastaj për zbatimin e tij përgjegjëse është Ministria e Administratës Publike përmes “Pirollit”. Sa i përket raportit, vlerësimi është pozitiv, por të gjeturat duhet trajtuar në mënyrë që në vitin e ardhshëm të mos përsëriten të njëjtat.

*Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri e nxori këtë*

## PËRFUNDIM

*Raporti nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.*

#### **4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010**

*Kryetari konstatoi se në mungesë të Avokatit të Popullit, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri e nxori këtë*

#### **PËRFUNDIM**

*Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010, shtyhet për mbledhjen e Komisionit të datës 20 korrik 2011.*

#### **5. Të ndryshme**

##### **a) Diskutim rreth temave të mundshme të auditimit të performancës për vitin 2011/2012**

*Komisioni së bashku me auditorin e përgjithshëm diskutuan rreth temave të mundshme për auditim të performancës për vitin 2011/2012.*

##### **b) Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës**

**Valbona Dibra** – Raportoj rreth aktiviteteve të Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës.

*Sipas nenit 65 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni vazhdoi punimet me dyer të mbyllura.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E Përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

---

Ali Sadriu